

GIUSEPPINA TURANO

ROLI I SHKENCAVE ALBANOLOGJIKE PËR NJOHJEN E SHQIPES DHE TË SHQIPËRISË NË ITALI

1. Hyrje

Në këtë shkrim të shkurtër do të flasim për studimet që kanë shënuar përhapjen e njohjes së gjuhës shqipe dhe të Shqipërisë në Itali. Këtu do të kufizohemi vetëm tek studiuesit italianë dhe arbëreshë që janë marrë me botën shqiptare dhe do të lëmë mënjanë veprat kushtuar dialekteve arbëreshe të Italisë.

Studimet albanistike në Itali datojnë të paktën që nga fillimi i shekullit XVIII. Tematikat e përfshira janë të shumta. Përveç studimeve në fushën e gjuhësisë, ka studime në fushën e letërsisë, atë etnografike, gjeografike, historike, antropologjike dhe në fushën politike. Ky shkrim nuk ka për qëllim që të përfshijë të gjitha këto fusha, as të hyjë thellë në fushat e përzgjedhura (gjë e pamundur): synimi është t'i jepen lexuesit disa referenca të studiuesve të ndryshëm duke cituar veprat dhe artikujt që në gjykimin tonë janë më kryesore. Përfshihen këtu veprat historike. Autorët dhe veprat e cituara do të ndahen sipas fushave dhe, brenda çdo fushe, do të ndiqet kriteri kronologjik.

2. Studime gjuhësore

Së pari, do të ndalojmë tek fusha e gjuhësisë. Në studimin e kësaj lënde të gjerë, studiuesit italianë dhe arbëreshë janë ndalë në mënyrë të veçantë në çështjen e origjinës së gjuhës shqipe; në përcaktimin e prejardhjes së saj; në vendin që zë shqipja në kuadër të gjuhëve indoeuropiane; në raportet e saj me gjuhët e tjera të Ballkanit. Janë hulumtuar fusha të përcaktuara si ajo e fonetikës, morfologjisë, leksikografisë dhe e sintaksës. Shumë është shkruar që nga fillimi i shekullit XVIII.

2.1. Studimet e autorëve të shekullit XVIII

Shkencat albanologjike në Itali kanë filluar në shekullin XVIII. Vepra e parë kushtuar gjuhës shqipe është *Dittionario italiano-albanese* “Fjalor italisht-shqip” (1702)¹, vepër në dorëshkrim e misionarit françeskan Francesco Maria Da Lecce (?-1718) që përmban mbi 11.200 njësi leksikografike. Vepra është me rëndësi themelore si për studimin e historisë së gjuhës shqipe, ashtu dhe për

¹ Shih Gurga (2009) dhe Kore (2020).

morfologjinë historike, duke qenë se në të gjejmë të regjistruar trashëgiminë shqiptare nga fundi i shekullit XVII. Mund të themi se, me këtë fjalor dygjuhësh, në fakt, zë fill leksikografia shqipe dhe se autori mund të konsiderohet si një ndër themeluesit e albanologjisë.

Nga i njëjti autor është botuar vepra *Osservazioni grammaticali nella lingua albanese* “Vëzhgime mbi gramatikën e gjuhës shqipe” (1716). Këtu autori merr parasysh të gjitha elementet e gramatikës shqipe. Ai jep shpjegime të hollësishme lidhur me emrat, që i ndan në tre lakime: i pari përfshin emrat femërore; i dyti, emrat mashkullore që kanë nyjën e shquar *-i*, dhe i treti përfshin emrat mashkullore me trajtën e shquar *-u*. Pas emrave, merret me trajtimin e përemrave duke u fokusuar në llojet e përemrave vetorë, pronorë, dëftorë, lidhorë. Në vijim, sjell përshkrimin e mbiemrave, numërorëve, parafjalëve, ndajfoljeve. Pas këtyre, në mbyllje të veprës, trajton foljet, të cilat i ndan në dhjetë zgjedhime, dhe ndan më vete foljet që nuk bëjnë pjesë në asnjë nga këto grupe zgjedhimesh, duke i emërtuar si folje të parregullta.

Vepra e Da Lecce-s, siç e shkruan vetë autori, ka qëllim të dyfishtë: nga njëra anë u drejtohet misionarëve italianë, të cilët mund ta përdorin për të mësuar gjuhën shqipe, e nevojshme për përhapjen e fesë katolike në trevat shqiptare, dhe, nga ana tjetër, u drejtohet shqiptarëve të të gjitha trevave, me synimin që të njihen me formën e shkruar të idiomës së tyre.

Në gjysmën e shekullit tetëmbëdhjetë, vazhdojnë studimet në fushën e leksikografisë me studiuesin arbëresh Nicolò Chetta (1741-1803)², i cili është autor i disa dorëshkrimeve të pabotuara. Do të përmendim këtu veprat: *Vocabolario italiano-albanese* “Fjalor italisht-shqip”, që përmban përafërsisht 5000 njësi leksikografike; dorëshkrimin *Etimologico della lingua albanese* “Etimologjiku i gjuhës shqipe” (1779) që përmban më shumë se 10.000 njësi leksikografike; veprën *Saggio di grammatica* “Ese mbi gramatikën” në të cilën autori trajton aspekte gramatikore të gjuhës shqipe, pra merret me emrat, mbiemrat, ndajfoljet dhe foljet; dhe dorëshkrimin me titull *Tesoro di notizie su de' Macedoni* “Thesar mbi Makedonasit” që trajton çështjen e origjinës së gjuhës shqipe. Chetta e dallon shqipen nga greqishtja dhe latinishtja, dhe, duke u bazuar në pozitën gjeografike, e klasifikon si gjuhë pellazgjike.

2.2. Studimet e autorëve të shekullit XIX dhe XX

Një shekull më vonë, edhe studiuesi arbëresh Girolamo de Rada (1814-1903), në veprën e tij *Antichità della nazione albanese e sua affinità con gli Elleni e i Latini* “Lashtësia e kombit shqiptar dhe afiniteti i tij me Helenët dhe Latinët” (1864), duke interpretuar gabimisht disa etimologji pellazgjike dhe disa elemente të onomastikës greke, shkruan se shqiptarët janë pasardhësit e Pellazgëve, banorët e parë të Greqisë.

² Shih Mandalà (1992).

Me etimologjinë dhe me origjinën e gjuhës shqipe merret edhe prifti arbëresh Demetrio Camarda (1821-1882), i cili në veprën e tij *Saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese* “Ese krahasuese gramatikore mbi gjuhën shqipe” (1864) trajton marrëdhëniet e fjalëve shqipe me ato të sanskritishtes, latinishtes, italishtes dhe greqishtes. Duke krahasuar shqipen me këto gjuhë, arrin në përfundimin se, edhe pse gjuha shqipe ka shumë fjalë latine, elementi më i madh i leksikut shqip është me origjinë greke. Pra, Camarda, ndryshe nga Chetta dhe De Rada, e lidh gjenetikisht shqipen me greqishten.

Rreth viteve '30 të shekullit XX, një tjetër misionar merret me studimin shkencor të gjuhës shqipe. Është at Fulvio Cordignano (1887-1952) i cili boton, në vitin 1931, veprën *Lingua albanese* “Gjuha shqipe”. Përveç variantit toskë, autori trajton edhe disa çështje gjuhësore të dialektit gegë. Autori trajton edhe frazeologjinë dhe sjell 112 proverba shqip, për të cilat jep përkthimin italisht. Cordignano është edhe autor i fjalorit *Dizionario albanese-italiano e italiano-albanese* “Fjalor shqip-italisht dhe italisht-shqip” (1934).

Në të njëjtën periudhë i kthehet relacionit shqip-greqisht gjuhëtari italian Matteo Bartoli (1873-1946), i cili, në vitin 1932 boton një monografi me titull *Accordi antichi tra l'albanese e le lingue sorelle* “Konkordanca të lashta midis gjuhës shqipe dhe motrat e saj” ku përpiket të tregojë, nga njëra anë afërsinë, dhe nga ana tjetër mospërputhjet midis shqipes dhe greqishtes. Nga kjo përqsasje, autori arrin në përfundimin se shqipja përputhet me greqishten dhe me gjuhët e jugut vetëm në elementet inovative, kurse në elementet konservative, ajo përkon me baltishten. Lidhur me problemin e prejardhjes së shqipes, autori heton serinë e guturaleve indoeuropiane dhe zhvillimin e tyre në gjuhën shqipe (1940).

Në gjysmën e shekullit të kaluar, me gjuhën shqipe merret edhe studiuesi arbëresh Marco La Piana (1883-1958). Vepra e parë kushtuar gjuhës shqipe është *Studi linguistici albanesi* “Studime gjuhësore shqipe”, me karakter filologjik, botuar në vitin 1939. Mbeten akoma të pabotuara veprat *Grammatica comparata della lingua albanese*³ “Gramatikë krahasuese e gjuhës shqipe” dhe *Il dizionario etimologico: evoluzione diacronica dell'albanese*⁴ “Fjalori etimologjik: evolucioni diakronik i shqipes”. Tek *Gramatika* La Piana përpiket të rindërtojë evolucionin fonetik dhe morfologjik të shqipes duke krahasuar shqipen me gjuhët e tjera indoeuropiane. Duke u nisur nga disa çështje të fonetikës dhe të morfologjisë historike, ai shtron hipotezën për gjuhën shqipe: dy sisteme evolucioni fonetik: një sistem *satem* dhe një sistem *kentum*, të pavarur nga njëri-tjetri. La Piana paraqet hipotezën se, gjatë zhvillimit të gjuhës shqipe, elementi *kentum* i është shtuar elementit *satem* dhe

³ Shih Gurga (2012).

⁴ Shih Mandalà (2012).

nga kjo mund të shpjegohen konvergjenat me elementet e gjuhës greke, e cila është gjuhë *kentum*. Sipas autorit, një grupi të lashtë të folësve *satem*, që fliste protoshqipen dhe që banonte në pjesën qendrore të Gadishullit Ballkanik, i është shtuar një grup folësish *kentum* që fliste një dialekt të ngjashëm me protogreqishten, dhe nga bashkimi i tyre është përfutur shqipja pararomake që përmban si tiparet *satem*, ashtu edhe tiparet *kentum*. Me këtë teori, autori shpjegon konvergjenat midis shqipes, që është gjuhë *satem*, dhe greqishtes, që është gjuhë *kentum*. Pjesa më thelbësore e veprës i kushtohet morfologjisë historike, ku autori mëton të argumentojë se shqipja është një vazhdim i drejtpërdrejtë i gjuhës indoeuropiane.

Me interes është *Fjalori etimologjik*, në të cilin autori ka marrë në shqyrtim mbi 30.000 fjalë që i ndan në bazë të origjinës së tyre: pra 5000 fjalë janë të panjohura por preindoeuropiane, 10.000 janë indoeuropiane, 3000 janë me origjinë latine, 2000 me prejardhje sllave, 3000 nga greqishtja, 3000 nga turqishtja, 4000 të papërcaktuara por jo indoeuropiane. Elementin leksikor arkaik e ndan në tri grupe: elementi preindoeuropian, elementi indoeuropian *satem* dhe elementi indoeuropian *kentum*. Duke e vënë theksin tek sasia e madhe e elementit indoeuropian brenda leksikonit shqiptar, autori kritikon hapur konkluzionin e Meyer-it (1891) se gjuha shqipe është gjysmë latine. Ky fjalor çmohet për pasurinë leksikore dhe frazeologjike të shqipes.

Në vazhden e studimeve që merren me prejardhjen e shqipes hyn dhe puna e glotologut Francesco Ribezzo (1875-1952), i cili, edhe pse trakët dhe ilirët i sheh si përfaqësues të të njëjtit etnos, pra si dy popuj që kanë folur një gjuhë të vetme, shqipen e konsideron si pasardhëse të gjuhës ilire (1940). Autori bazohet në marrëdhëniet që, në kohë e në hapësirë, lidhin shqipen me ilirishten e vjetër, pra përpiqet të vërtetojë vazhdimin gjeografik të shqiptarëve të sotëm nga ilirët e lashtë.

Aty nga mesi dhe fundi i viteve '50 të shek. XX gjejmë studimet e gjuhëtarit italian Giuseppe Restelli i cili, duke u marrë me gjuhësinë historiko-krahasuese indoeuropiane, përfshin në studimet e tij edhe gjuhën shqipe (1956, 1957, 1960). I interesuar kryesisht në fushën e fonetikës historike, ky studiues ka hulumtuar izoglosat që, në sistemin e zanoreve dhe të bashkëtingëllorëve, bashkohen protoshqipen me trakishten, me armenishten e me iranishten dhe që, sipas tij, janë formuar në vendin ku banonin fiset e para dhe më të vjetra shqiptare, dmth. në stepat midis Detit të Zi dhe Detit Kaspik. Izoglosat e përbashkëta janë rezultat i shkëmbimeve ndërgjuhësore mes fiseve nomade që jetonin në të njëjtën hapësirë. Edhe përkimet fonetike rumuno-shqiptare i sheh si rezultat i kontakteve të protoshqiptarëve me fiset e dakëve.

Edhe studiuesi Vittore Pisani (1899-1990) merret me raportet e shqipes me gjuhët e tjera indoeuropiane dhe me origjinën e saj. Në vëllimin *Saggi di Linguistica storica* "Ese mbi gjuhësinë historike" (1959), që përfshin kapitullin *L'albanese e le altre lingue indoeuropee* 'Shqipja dhe gjuhët e tjera

indoeuropiane', autori e sheh shqipen në përqasje me gjuhët e tjera indoeuropiane, për të vënë në dukje disa dukuri paralele të lashta midis tyre. Pisani trajton veçanërisht katër dukuri morfologjike: e para është prapavendosja e nyjës së shquar, për të cilën shkruan se e gjejmë jo vetëm në shqipe, por edhe në bullgarishte dhe në rumanishte, hapësirë në të cilën dikur flitej trakishtja, ashtu siç e gjejmë edhe në armenishte dhe në gjermanishte. Veçoria e dytë është reduktimi i numrit të rasave në krahasim me tipin e lashtë indoeuropian, nga tetë në pesë, pra përputhja e gjinore me dhanoren. Veçoria e tretë për të cilën bën fjalë ky autor është lakimi binar i shquar / i pashquar. Veçoria e katërt që merr në shqyrtim është nyja e përparme e gjinore dhe ajo e mbiemrave. Të njëjtën veçori e gjejmë në rumanishte ashtu si dhe jashtë gadishullit ballkanik, në iranishte. Pra, kjo izoglosë bashkon shqipen me trakishten dhe me iranishten. Në fund të kapitullit autori thekson se këto tipare të përbashkëta e lidhin gjuhën shqipe nga njëra anë me gjuhët gjermanike dhe me baltosllaven, dhe nga ana tjetër me armenishten, me iranishten dhe me tokarishten.

Për sa i përket çështjes së prejardhjes së shqipes, Pisani (1964) përkrah teorinë ilire duke sjellë kështu në fokus edhe vendosjen e popullit në hapësirën ballkanike.

Për origjinën e shqipes, kemi edhe studimet e Carlo Tagliavini-t (1903-1982) i cili, në vitin 1965 botoi librin *La stratificazione del lessico albanese: elementi indoeuropei* "Shtresëzimi i leksikut të shqipes: elemente indoeuropiane". Për të përcaktuar vendin ku është formuar gjuha shqipe, autori bazohet në hapësirën ku kanë jetuar fiset proshqipe. Sipas Tagliavini-t, vendi i hershëm i shqiptarëve do të ketë qenë në afërsi me të rumunëve, siç e dëshmojnë konkordancat midis rumanishtes dhe shqipes dhe shtron hipotezën e hapësirës dardane si territor, edhe pse kjo është tepër larg nga territori grek dhe nuk arrin të shpjegojë huazimet greke të lashta të shqipes.

Duke vijuar me kriterin kronologjik, në vitin 1972 botohet libri *Manuale di lingua albanese* "Manual i gjuhës shqipe". Autori është at Francesco Solano (1914-1999). Është një gramatikë deskriptive e gjuhës shqipe, hartuar për studentë, ku përveç përshkrimit të të gjitha kategorive gramatikore, jepen dhe ushtrime në fund të çdo argumenti. Kjo konsiderohet si gramatika e parë që ndjek normën e gjuhës shqipe standarde.

Në vitin 1976 kemi një kontribut shumë të diskutueshëm të gjuhëtarit italian Giulio Bonfante (1904-2005) me titullin *Albanese ed Illirico* "Shqipja dhe Ilirishtja" ku autori thekson se në Gadishullin Ballkanik, në kohët e lashta, banonin dy fise indoeuropiane: trakët dhe ilirët. Gjuha trake ishte *satem*, kurse ilirishtja ishte *kentum*. Fakti që sot shqipja është gjuhë *satem* tregon se ajo vazhdon gjuhën trake dhe jo atë ilire. Si dëshmi merr tiparet e përbashkëta gjuhësore midis rumanishtes dhe shqipes: sipas autorit, korrespondencat shqipo-rumune vijnë nga fondi i përbashkët trakas, sepse edhe rumanishtja, si

shqipja, është gjuhë trake. Duke u bazuar në disa izoglosa rumuno-shqiptare (në fonologji dhe në leksikon), që nuk gjenden në gjuhët e tjera ballkanike, autori e zhvendos atdheun origjinal të shqiptarëve në Veri. Pra, shtron hipotezën se shqiptarët ishin banorë të hershëm të Dacisë dhe jo popullsi autoktone në vendbanimin e tyre të sotëm. Bonfante arrin në përfundimin se rumunët dhe shqiptarët dikur ishin një popull i vetëm që fliste të njëjtën gjuhë dhe se më vonë shqiptarët migruan në vendndodhjen e tyre aktuale.

Edhe Riccardo Ambrosini (1925-2008) ka trajtuar marrëdhëniet e gjuhës shqipe me gjuhët e tjera indoeuropiane. Duke folur për truallin ku është formuar gjuha shqipe dhe për evolucionin e strukturës së saj gramatikore, ai dallon dukuritë që shqipja i ka trashëguar prej një faze të hershme nga ato dukuri që i konsideron si zhvillime të reja, të përfuara gjatë evolucionit të saj historik. Autori merret me disa veçori që i përkasin fushës së morfologjisë: përmend kundërvënien e kategorisë së caktuar dhe të pacaktuar; rimarrjen e kundrinës me anë të formave të patheksuara të përemrave vetorë; citon procesin e formimit të zgjedhimit jovepror, për të cilin thotë se mbaresat vetore të posaçme në kohën e tashme dhe në kohën e pakryer janë një dukuri arkaike që e afron shqipen me iranishten; kurse forma analitike me pjesëzën *u* për kohën e kryer të thjeshtë, për dëshiroren, habitoren dhe paskajoren, si dhe format perifrastike me foljen ndihmëse *jam*, janë të periudhave të ndryshme: nga njëra anë, kanë hyrë në gjuhën shqipe falë vendndodhjes qendrore të saj në kuadrin e gjuhëve indoeuropiane, kurse nga ana tjetër, janë rezultat i një evolucioni të gjatë historik, që gjuha shqipe ka pësuar në mënyrë të pavarur në truallin ballkanik. Përfundimi i autorit është së konvergencat e shqipes me gjuhët balto-sllave lidhen me afërsinë dhe pozicionin gjeografik të këtyre gjuhëve në kohërat antike. Burimin e konvergencës së shqipes me gjuhët balto-sllave, autori e shpjegon me faktin se nga viti 2500 deri 2000 para Krishtit gjuha shqipe flitej deri në Poloninë e sotme, kurse konvergencat e shqipes me iranishten dhe armenishten datojnë diku nga viti 2000 deri në vitin 1500 para Krishtit dhe lidhen me migrimet në Rumaninë e sotme (1982, 1996).

Edhe Paolo di Giovine (1957) është rrekur të shpjegojë origjinën e gjuhës shqipe, duke u bazuar në të dhëna fonologjike. Në punimet e tij (1979, 1982), duke krahasuar sistemin fonologjik të shqipes me atë të trakishtes, studiuesi arrin në përfundimin se midis këtyre gjuhëve nuk ka lidhje gjenetike. Sipas tij, as nuk mund të flitet për një prejardhje dako-meze të shqipes, pavarësisht nga disa zhvillime paralele, të cilat në fakt janë të pavarura. Sipas tij, shqipja nuk ka lidhje as me ilirishten, sepse të dhënat që justifikojnë tezën e prejardhjes ilire të shqipes janë të pakta, pra të pamjaftueshme. Megjithatë, autori flet për hapësirën ku është formuar shqipja, duke saktësuar se në fillim të epokës së krishterë shqipja ka qenë në kontakt me latinishten e Dalmacisë. Më vonë ajo ka qenë nën ndikimin e latinishtes danubiane dhe këto ndikime kanë prekur sistemin fonologjik, morfologjik dhe sintaksor të shqipes.

Pak a shumë në të njëjtën periudhë edhe studiuesi Emanuele Banfi (1946) trajton çështjen e territorit ku është formuar gjuha shqipe dhe saktëson se kjo përputhet me hapësirën midis Shkodrës, Prizrenit, Ohrit, Vlorës. Duke u nisur nga fakti që gjuha shqipe ka shumë elemente latine, Banfi shkruan se kjo është folur në një hapësirë romane që përfshin tri zona: atë dalmate, danubiane, dhe zonën e Via Egnatia-s (Banfi 1972).

Me Emanuele Banfi-n shkencat albanologjike marrin një drejtim tjetër, gjithnjë me karakter krahasues. Në librin e tij *Linguistica balcanica* 'Gjuhësi ballkanike', botuar më 1985, ky studiues orientohet drejt marrëdhënieve të gjuhës shqipe me gjuhët e tjera të folura në arealin ballkanik. Siç dihet, bashkësia gjuhësore ballkanike përfshin dy gjuhë indoeuropiane të dallueshme nga njëra-tjera, greqishten e re dhe shqipen; disa gjuhë sllave, si bullgarishten, kroatishten, maqedonishten, serbishten, sllovenishten; një gjuhë romane: rumanishten, dhe një gjuhë joindoeuropiane, turqishten, edhe pse kjo nuk flitet në arealin ballkanik. Këto gjuhë të folura në arealin ballkanik kanë disa tipare të përbashkëta, të cilat nuk rrjedhin nga një prejardhje e përbashkët, sepse, siç dihet, nuk kanë afri gjenetike. Tiparet e përbashkëta janë krijuar për shkak të kontaktit gjuhësor, sepse këto gjuhë rrojnë krah për krah, pra janë tipare që janë zhvilluar si rezultat i një ndërndikimi gjuhësor. Banfi bën një dallim midis ballkanizmave parësorë, që karakterizojnë gjuhën bullgare, maqedonase, rumune dhe shqipe, dhe ballkanizmave dytësorë, që gjenden në të paktën në dy gjuhë ballkanike me kusht që këto dy gjuhë të mos i përkasin së njëjtës familjeje gjuhësore. Si ballkanizma parësorë Banfi përmend: përputhjen e gjinore me dhanoren; prapavendosjen e nyjës; humbjen ose kufizimin e paskajores; formimin e kohës së ardhme përmes foljes *dua*; dyfishimin e kundrinorit me anë të formave të patheksuara të përemrave vetorë. Nga ana tjetër, si ballkanizëm dytësor përmend përdorimin e parafjalës *me*, e cila kërkon një sintagmë emërore të shquar: *me shqiptarët*, *me hoxhën*. Kjo dukuri e lidh gjuhën shqipe me rumanishten.

Libri i tij, edhe në ditët tona, mbetet një nga manualët më të mira të gjuhësisë ballkanike.

Me karakterin indoeuropian dhe ballkanik të gjuhës shqipe merret edhe Giovan Battista Pellegrini (1921-2007), i cili, shqipen e ka bërë objekt studimi në veprën e tij *Avviamento alla linguistica albanese* "Hyrje në gjuhësinë shqipe", botuar më 1998. Autori në fillim trajton mënyrën se si shkruhet dhe shqiptohet gjuha shqipe, duke prezantuar fonemat e saj, zanoret dhe bashkëtingëlloret, sipas rendit alfabetik. Këtu merret edhe me dy dialektet e gjuhës shqipe dhe vë në dukje dallimet midis gegërishtes dhe toskërishtes. Më tej vijon duke dhënë një sintezë të studimeve kushtuar gjuhës shqipe që nga Leibniz-i (1646-1716) deri në vitet e fundit të shekullit të kaluar. Pas kësaj hyrjeje, Pellegrini përshkruan gjuhët e lashta të Gadishullit Ballkanik duke caktuar hapësirën gjeografike në të cilën fliteshin. Këtu përmend gjuhët trake,

pellazge, maqedonase, proto-frigje, mesape, dake, moese, ilire dhe përqendrohet në raportet midis tyre. Vazhdon më tej duke trajtuar karakterin indoeuropian të gjuhës shqipe, gjë që e vërteton duke përdorur të dhëna nga fusha e fonetikës dhe e morfologjisë, si dhe duke marrë në konsideratë konkordancat leksikore midis shqipes dhe gjuhëve të tjera i.e., pra konkordancat me greqishten, me armenishten, me gjuhët gjermanike, me gjuhët balto-sllave, me latinishten, me keltishten, me iranishten. Duke u nisur nga faza indoeuropiane, autori përshkruan evolucionin historik të strukturës gramatikore të shqipes përmes ndërrimeve morfologjike në sistemin emëror (gjininë, nyjat, rasat), në atë mbiemëror, përemëror, numëror, foljor dhe parafjalor. Një kapitull tjetër i kushtohet vendit të shqipes në kuadër të gjuhëve ballkanike. Pellegrini e klasifikon gjuhën shqipe si gjuhë ballkanike të shkallës së parë, sepse ka një numër të madh bashkëpërkimesh me gjuhët e tjera të Ballkanit dhe vijon të marrë gjithaq parasysh elementin latin në gjuhën shqipe sidomos në fushën e leksikografisë. Në përmbyllje të librit të tij i kushton vëmendje arbërishtes dhe teksteve më të vjetra shqipe.

2.3. Dekadat e fundit të shekullit XX

Siç u vu re deri këtu, studiuesit italianë dhe arbëreshë kanë hulumtuar fusha të ndryshme: nga fonetika historike te morfologjia, nga etimologjia te leksikografia. Ata janë marrë me hartimin e fjalorëve dhe gramatikave duke iu qasur shqipes me metodat e gramatikës deskriptive. Kanë bërë po ashtu studime krahasuese indoeuropiane dhe ballkanike.

Duke u nisur nga vitet '80 të shekulli të kaluar, shkencat albanologjike tejkalojnë përshkrimet tradicionale dhe marrin një perspektivë më bashkëkohore. Edhe këtu do të kufizohemi te studiuesit që janë marrë me botën shqiptare, duke lënë mënjanë punimet kushtuar botës arbëreshe.

Në fushën e gjuhësisë, kontributet e kësaj periudhe shprehin një interes sidomos ndaj filologjisë, leksikografisë dhe sintaksës.

Francesco Altimari (1955) është një ndër përfaqësuesit më të denjë të plejadës së albanologëve italianë. Me punimet e tij të thelluara dhe me nivel të lartë shkencor ai është angazhuar si në fushën e gjuhësisë, ashtu edhe në fushën e letërsisë shqipe. Ka trajtuar tema komplekse të gjuhësisë diakronike shqiptare, si: zhvillimi i zanoreve gege dhe toske (1981), formimi i habitores së shqipes (1992), çështja e paskajores (2010), leksikografia tekstuale e kompjuterizuar (1996).

Në studimet e tij ai zbaton metodat moderne të filologjisë, përmes analizimit të leksikut letrar të veprave. Altimari është ndër të parët gjuhëtarë që aplikoi metodën elektronike të konkordancave leksikore (1991), si dëshmohe në botimin filologjik të poemës *Bagëti e Bujqësi* të Naim Frashërit (1994). Puna e tij shtrihet edhe në fushën e letërsisë shqipe. Ai është studiues i letërsisë së Rilindjes (1984), si dhe studiues i romaneve të Ismail Kadaresë (2008). Me kërkimet e tij shkencore ka rinovuar filologjinë, dialektologjinë, leksikografinë

(elektronike) dhe kritikën letrare (1991). Falë qasjes dhe metodës së kërkimit shkencor, arritjet e Altimari-t e kanë ngritur në një nivel të lartë shkencën albanologjike në Itali.

Giovanni Belluscio (1961-2020) zë një vend të veçantë si për nivelin akademik të studimeve të tij, ashtu edhe për metodat e zbatuara. Studiues i fonetikës, i fonologjisë, i dialektologjisë shqiptare, ka qenë i pari autor që ka aplikuar fonetikën eksperimentale në gjuhën shqipe dhe dialektet e saj (1993a, 1993b, 1995, 2015). Ka trajtuar me imtësi mbylltoret e shqipes, cilësinë fonetike dhe gjatësinë e tyre (2005); është marrë gjithashtu me zanoret hundore të shqipes (Belluscio e Mendicino 2018). Falë ekspeditave gjuhësore të kryera në pjesën veriore të Shqipërisë, si dhe kërkimeve në terren, konkretisht në Theth (Belluscio e Genesin 2010) dhe në Vermosh (2009b), Belluscio ka dhënë një kontribut të madh edhe në fushat e leksikografisë dhe të sociolinguistikës. Ka studiuar variantet fonetike “tendenciale” në përdorimin e shqipes standarde në emisionet televizive të sotme (2016); çështje të shqiptimit të gjuhës shqipe në Ballkan (2012b); shqiptimin e shqipes standarde në Prishtinë vs Tiranës (2018). Përveç studimeve gjuhësore, ai ka analizuar variantet e romaneve të Kadaresë (2007, 2011, 2012a) dhe, nga i njëjti autor, ka përkthyer disa poezi në italisht. Është marrë me përkthimin e veprës *Ylli i zemrës* të Lasgush Poradecit (2009a).

Monica Genesin (1963) është marrë me etimologjinë dhe me leksikografinë e gjuhës shqipe (1991, 1993), me mënyrat e formimit të shumësit të emrave (2007), me rolin e nyjave të shquara në gjuhën shqipe në krahasim me rumanishten dhe me greqishten (1998), me morfologjinë historike të foljeve shqipe (1994, 2001, 2005). Është interesuar edhe për të folmen e Thethit (Belluscio e Genesin 2010) dhe për tekstet e Buzukut dhe të Bogdanit.

Ka një fushë tjetër në të cilën albanistika në Itali është bërë objekt studimi: gjuhësia gjenerative. Në këtë fushë mbizotërojnë studimet që merren kryesisht me sintaksën dhe me morfosintaksën. Për sa i përket gjuhës shqipe, studimet gjenerative fillojnë pas viteve ‘90 me studiuesen Giuliana Giusti (1961) nga Universiteti i Venecias. Specialiste e sistemit emëror, Giusti ka analizuar një shqese që i prapavendoset emrit (1995), sintagmat ku emri shoqërohet nga një mbiemër (1997), njëën e përparme të mbiemrave dhe atë të rasës gjinore (2012).

Një qendër tjetër në Itali ku ka pasur dhe vazhdon të ketë interes për gjuhën shqipe, brenda kuadrit teorik gjenerativist, është Universiteti i Firences. Dy studiues të këtij Universiteti, Leonardo Maria Savoia (1948) dhe Maria Rita Manzini (1956), kanë trajtuar një sërë çështjesh në fushë të morfosintaksës.

Në punimet e tyre të para, duke përdorur si bazë empirike gegërishten e Shkodrës, dy autorët janë marrë me format foljore të pashtjelluara, sidomos me pjesoren (2003, 2007) dhe me paskajoren (2003, 2007). Çështje të tjera të trajtuara pre tyre janë: diateza joveprore (1999, 2008), struktura e sintagmave

emërore (2010, 2011, 2012a), dhe, lidhur me këtë, sistemi rasor i emrave dhe i përemrave (2011, 2012b), si dhe çështja e nyjave që u paraprijnë mbiemrave dhe rasës gjinore (2014).

Në domenin e fjalive të nënrenditura, Manzini dhe Savoia janë marrë me statusin kategorial të elementit *se*, që u paraprin fjalive me folje në dëftore, dhe të elementit *që*, i cili u paraprin fjalive të nënrenditura me folje në lidhore (2018). Manzini dhe Savoia janë ndër të paktët studiues që kanë zbatuar parimet dhe metodat gjenerative-transformacionale në sintaksën e gjuhës shqipe.

3. Studime letraro-kulturore dhe filologjike

Fusha të tjera që kanë ndihmuar për njohjen e Shqipërisë në Itali janë ajo e letërsisë, e kulturës dhe e filologjisë. Interesimin për letërsinë dhe kulturën shqipe e gjejmë fillimisht tek studiuesi Gaetano Petrotta (1882-1952). Me librat e tij (1913, 1932), ai ofron një imazh të plotë të kulturës shqiptare; analizon historinë e popullit, gjuhën dhe dialektet, historinë e letërsisë, duke i kushtuar vëmendje të veçantë periudhës së Rilindjes. Petrotta, duke u marrë me tekstet e vjetra, ka rindërtuar historinë e shkrimit në gjuhën shqipe dhe historinë e studimeve letrare (1950).

Giuseppe Schirò junior (1905-1984), në punimin e tij kushtuar letërsisë shqipe merret me letërsinë popullore dhe me letërsinë fetare, trajton poetët e Rilindjes dhe sidomos përfaqësuesit e dy shkollave shkodrane: Ndre Mjeda dhe Gjergj Fishta. Ai analizon veprën e Koliqit dhe letërsinë e pasluftës. Ka një qasje krahasuese të çdo periudhe mes letërsisë shqipe dhe asaj arbëreshe. Pra vepra e tij shtegton mes binarëve paralelë: shqip-arbërisht (1959).

Me rëndësi të veçantë është edhe vepra e studiuesit arbëresh Antonino Guzzetta (1922-2017). Për sa i përket botës shqiptare, Guzzetta, përveç se ka studiuar gjuhën shqipe në shekullin e pesëmbëdhjetë në dokumentacionin venecian të kohës (1968-1973) dhe marrëdhëniet midis arbëreshëve dhe shqiptarëve ndër shekuj (1987), është marrë gjithaq sidomos me letërsinë, duke u përqendruar kryesisht në figurën e Ernest Koliqit, për të cilin ka studiuar pozicionin e tij midis traditës dhe modernitetit (1968, 1975), tematikat e veprave të autorit dhe në veçanti përmbledhjen e tregimeve *Hija e maleve*, të cilën, përveçse e ka përkthyer në italisht, e ka pasuruar me komente dhe me shënime historike e filozofike (1974).

Giuseppe Gradilone (1925-2020) ka qenë studiues i letërsisë shqipe moderne dhe bashkëkohore (1960, 1974). Ai ka analizuar krijimtarinë letrare të autorëve si Fishta, Frashëri, Gurakuqi, Koliqi, Mjeda (1983) dhe është marrë me ndikimin e diktaturës në letërsi dhe me qëndrimin e shkrimtarëve, si Agolli, Arapi, Trebeshina, Zhiti ndaj diktaturës (1997).

Për letërsinë e realizmit socialist ka dhënë kontribut edhe studiuesi Italo Costante Fortino (1947) në veprën e tij të vitit 1994. Filolog dhe studiues i

letërsisë, ai është marrë edhe me veprën e Kadaresë (2007), kurse në punime të tjera Fortino ka rikujtuar figurën e Skënderbeut, heroi kryesor i historisë së Shqipërisë i kudonjohur si mbrojtës i krishterimit kundër pushtimit otoman në Shqipëri dhe në Ballkan. I lidhur me Venedikun, Romën dhe Napolin, i lartësuar si “kampioni i krishterimit” dhe “atleti i Krishtit”, nga të gjitha kancelaritë europiane, Skënderbeu i priu për njëzet e pesë vjet rezistencës kundër mësymjes turke në Shqipëri dhe në Ballkan. Fortino ka përshkruar lidhjet dhe aleancat politike midis heroit kombëtar dhe shteteve të Europës Perëndimore.

Vend të rëndësishëm në fushën e albanologjisë zë studiuesi Elio Miracco (1944), filolog, studiues i letërsisë moderne dhe bashkëkohore shqipe dhe përkthyes në italishte i disa autorëve shqiptarë, si Agolli, Dones, Lubonja, Zhiti. Ai ka bërë kritikën e tekstit të romanit *Sikur t'isha djalë* të Stërmillit (2004), por është përqendruar veçanërisht në veprën e Kadaresë. Ka ndërtuar historinë e tekstit të romanit *Piramida* (1999); ka analizuar temën e trajtuar në romanin *Kështjella* (2007) dhe, duke hetuar strukturat gjuhësore të romaneve të Kadaresë, Miracco ka treguar se si, nëpërmjet një procesi të vazhdueshëm të ribërjes së veprave të tij, Kadareja në fund jep një tjetër “lloj” historie. Ky rishikim historik kombinohet me rishikimin e gjuhës, që manifestohet si aspiratë për një purizëm gjuhësor në emër të të cilit Kadareja fshin fjalët turke të përfshira në fondin leksikor shqiptar për t'i zëvendësuar me ato autoktone shqiptare (2011).

Një nga figurat më të shquara të albanologjisë së sotme është padyshim studiuesi Matteo Mandalà (1958) me veprimtarinë e tij shumëdisiplinare e të shumanshme. Edhe pse fusha mbizotëruese e studimeve të Mandalà-së është filologjia (1992, 1997, 2002, 2012), një vend me rëndësi zë edhe veprimtaria e tij në fushën e letërsisë dhe të kritikës letrare (2018a, 2004). Këtu mbizotërojnë studimet për poezinë dhe poetikën e Martin Camajt (1991, 1993a), por sidomos studimet lidhur me interpretimin e veprës letrare të Ismail Kadaresë (2009, 2017, 2018b). Me botimet kritike (2016a, 2016b, 2016c), me parathëniet e disa romaneve të Kadaresë (2008, 2011), Mandalà rindërton procesin e shkrimit të romaneve, si dhe dinamikat e procesit krijues të këtij shkrimtari. Me punimet e tij Mandalà ka hyrë në botën artistike të Kadaresë, si dhe në debatin midis tij dhe Qosjes për mbrojtjen e identitetit evropian të shqiptarëve dhe vokacionin e Shqipërisë si ballkanike dhe europiane (2006). Përveç këtyre studimeve, Mandalà është marrë me strukturën e rrëfimit në dramën *Besa* të Sami Frashërit (2005); me motivin e besës në letërsi (1993b); me çështjen e gjuhës së Rilindjes (1990a); me poezinë popullore dhe artistike shqipe (1990b).

4. Letërsia dokumentare

Një vëmendje të veçantë për njohjen e Shqipërisë në Itali e meritojnë intelektualët italianë, qoftë misionarë, gazetarë, gjeografë, politikanë, diplomatë, të cilët, në mënyra të ndryshme kanë shprehur opinionet dhe

mendimet e tyre për botën shqiptare duke filluar nga gjysma e shekullit XIX. Këtu do të kujtojmë librin *Albania* (1869), shkruar nga Pietro Chiara, nëpërmjet të cilit autori jep një pamje politiko-historike të Shqipërisë; kujton ndarjen midis Kishës Katolike romake dhe Kishës Ortodokse që i vuri shqiptarët kundër grekëve; mbron si të domosdoshme aleancën greko-shqiptare dhe i shtyn të dy popujt të bashkohen në një atdhe të vetëm për të luftuar së bashku kundër pushtuesit otoman. Ai vë në dukje karakterin krenar, të panënshtuar dhe luftëtar të shqiptarëve, të cilët tërë jetën e tyre kanë luftuar kundër armiqve të çdo race.

Interesi italian për Shqipërinë vjen e rritet në fillim të viteve 1900, si rrjedhojë e linjave politike me rëndësi strategjike të shtetit italian, i cili synonte të merrte në dorë kontrollin e Adriatikut: për politikën italiane territori shqiptar mund të përdorej për të kontrolluar zonat e Ballkanit. Pra, në fillim të shekullit XX, Shqipërinë e njohim përmes reportazheve të disa gazetarëve të dërguar nga qeveria italiane, si Antonino Paternò Castello (1852-1914)⁵, Vico Mantegazza (1856-1934)⁶, Eugenio Barbarich (1863-1931)⁷, Eugenio Vaina (1888-1915)⁸, të cilët trajtojnë çështjen e prejardhjes së shqiptarëve. Analizojnë po ashtu dallimet midis gegëve dhe toskëve si për sa u përket traditave, ashtu edhe trajtave antropologjike. Kështu gegët përshkruhen si krenarë, rebelë dhe luftarakë, të organizuar në fise, të mbyllur në vetvete dhe të organizuar sipas normave të kanunit, sipas një të drejte zakonore të pashkruar. Këta autorë përshkruajnë edhe jetën dhe bëmat heroike të Skënderbeut, pushtimin osman, si dhe marrëdhëniet me Venedikun. Sjellin po ashtu një tablo për disa qytete shqiptare si Shkodra, Durrësi, Tirana, Vlora, Janina.

I dërguar nga Ministria e Punëve të Jashtme, Arturo Galanti (1858-1920) ndërton një tablo mjaft negative rreth Shqipërisë (1901), bazuar kryesisht në prapambetjen e vendit, si dhe në faktin që nuk ka ruajtur thuajse asgjë nga qytetërimet e mëdha të së shkuarës. Edhe sa i takon historisë, sipas autorit, shqiptarët nuk kanë bërë kurrë luftëra të rëndësishme, me përjashtim të periudhës së Skënderbeut. Turqit konsiderohen si përgjegjës për prapambetjen e vendit.

Në të njëjtën linjë zhvillohen shkrimet e botanistit dhe gjeografit Antonio Baldacci (1867-1950), specialist i gjendjes etnografike, politike dhe socio-ekonomike të Shqipërisë. Është autori i veprave *Itinerari albanesi* (1917) dhe *L'Albania* (1929), si dhe i disa artikujve, botuar në revistën *Italia* (1913), në të cilët flet për Shqipërinë, për popullin shqiptar, për Shkodrën, për kanunin si bazë ligjore të jetës së përbashkët, për tiparet arkaike të traditave kombëtare.

⁵ Paternò Castello (1903).

⁶ Mantegazza (1912).

⁷ Barbarich (1905).

⁸ Vaina (1917).

Edhe Ugo Ojetti (1871-1946) mbledh në librin e tij, të shkruar në formë ditari (1902), përshtypjet e udhëtimit të tij në Shqipëri, nga Jugu në Veri, bërë në verën e vitit 1901 si korrespondent i gazetës *Corriere della Sera*. Autori përshkruan karakterin arkaik të kulturës shqiptare, situatën ekonomike dhe shoqërore, traditat dhe zakonet e Shqipërisë. Qëllimi i tij ishte dokumentimi i kontekstit shqiptar për të forcuar idenë e aneksimit të Shqipërisë në Itali.

Ka frymë politike edhe vepra *L'Adriatico degli altri: (l'Albania nell'ora presente)* "Adriatiku i të tjerëve: (Shqipëria e sotme)" e gazetarit Federico Ratti (1877-1944) në të cilën autori bën një përshkrim gjeografik, historik dhe shoqëror të vendit. Autori përshkruan në detaje, realitetin shqiptar, qytetin e Shkodrës dhe të Vlorës, flet për fenë myslimane dhe shpreson se Shqipëria mund të bëhet sa më parë e pavarur për të hyrë nën tutelën italiane.

Gjatë qëndrimit të tij në Shqipëri, edhe Fulvio Cordignano (1887-1952) kishte mbledhur një material dokumentar shumë të pasur, mbi historinë dhe etnografinë e vendit (1940). Më 1925 shkroi *Epojeja kombëtare e popullit shqiptar* dhe në vitin 1930 botoi veprën *La poesia epica del confine nell'Albania del Nord* "Eposi i kufirit i Shqipërisë Veriore". Cordignano është edhe autor i shumë artikujve botuar në disa revista, si *Voci dell'Oriente* "Zëra të Lindjes" dhe *Rivista d'Albania* "Revistë e Shqipërisë". Në këtë të fundit, në vitin 1941 botoi artikullin *L'Albania nella storia e nella vita* "Shqipëria në histori dhe në jetë", një studim etnografik në të cilin autori shkruan për kulturën popullore, për doket, zakonet e shqiptarëve në rrjedhën e historisë, por ky artikull u akuzua si shkrim me frymë antishqiptare duke qenë se autori vinte në dyshim unitetin e racës shqiptare, pastërtinë dhe prejardhjen e saj të drejtpërdrejtë nga Ilirët, madje vinte në pikëpyetje edhe të drejtën e popullit shqiptar për të populluar territorin në të cilin jetonte⁹.

Në vijim kemi studimet e Giuseppe Valentini-t (1900-2019) albanolog dhe bizantinist. Ai ka studiuar gjuhën, historinë dhe aspektet ligjore e administrative të Shqipërisë. Ka trajtuar marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Republikës së Venedikut në Mesjetë (1967). Studiuesi ka bërë studime mbi onomastikën dhe toponiminë; studimin e kanunit, një e drejtë e vjetër e pakodifikuar; ka përshkruar mendësinë shqiptare, ndjenjën e mikpritjes dhe të nderit; frymën heroike të malësorëve; konceptin e drejtësisë penale; zakonet dhe traditat e Shqipërisë mesjetare dhe moderne; strukturimin e fisit dhe organizimin e tij (1969).

Kemi po ashtu, shënimet e mbledhura nga Stefano Santucci gjatë udhëtimit të tij në Shqipërinë Veriore në vitin 1914. Mjek ushtarak, u dërgua në Shqipëri si anëtar i komisionit ndërkombëtar ngarkuar me përcaktimin e kufijve të Shqipërisë Veriore. Libri i tij flet për gjeografinë e vendit, jetën e banorëve, mënyrën se si jetojnë (në kasolle të varfra), si vishen (me rroba dhe këpucë të

⁹ Shih Martucci (2016).

papërshatshme për të ftohtin e maleve), për sëmundjet e tyre, që vijnë si pasojë e varfërisë. Flet për zakonet primitive të shqiptarëve, të cilët jetojnë të izoluar nga të gjitha format e qytetërimit, nuk dinë as të lexojnë e as të shkruajnë; abuzojnë me duhanin, rakinë dhe kafënë. Megjithatë, vijon më tej autori, vendi ka toka pjellore, pyje të pamata, gurore mermeri dhe minerale të ndryshme që, po të shfrytëzoheshin, mund ta bënin Shqipërinë një vend të pasur.

Siç shihet deri këtu, librat dhe artikujt e shkruar në fillim të shekullit XX janë me shumë vlera njohëse: ata hedhin dritë mbi historinë, gjeografinë, kulturën, mënyrën e jetesës materiale dhe shpirtërore të Shqipërisë para dhe pas çlirimit nga pushtuesi osman.

Mes propagandës dhe ideologjisë luhaten disa vepra të botuara në kohën e fashizmit nga Sandro Giuliani (1929)¹⁰ dhe Filippo Tafani (1932)¹¹. Në këto vepra, me orientim politik, vlerësohet populli shqiptar, kultura e tij e lashtë, potenciali ekonomik i vendit, forca e popullit që ka mbrojtur kombësinë, pavarësinë, gjuhën, lirinë, krenarinë. Shqipëria shihet si vend me të cilin Italia ka marrëdhënie të përzemërta dhe të sinqerta, ku flitet gjerësisht gjuha italiane, ku njerëzit janë mikpritës dhe të sjellshëm; vend me të cilin shkëmbimet tregtare janë intensive. Pra, në këto shkrime ndryshon vizioni i Shqipërisë: jo më si shtet i prapambetur, por si një vend në rrugën e progresit, falë ndihmës së popullit italian. Siç mund të kuptohet, Shqipëria bëhet gjithnjë e më shumë objekt interesi ekonomik për Italinë. Veprimtaria e tyre propagandiste ishte pjesë e politikës filoshqiptare të Musolini-t.

Panorama rreth Shqipërisë plotësohet nga gjeografi Roberto Almagià (1884-1962) i cili sjell një përshkrim të Shqipërisë për *Enciklopedinë Italiane* (1929). Autori shpjegon strukturat e shoqërisë shqiptare, të familjes dhe të fisit. Trajton ekonominë bujqësore dhe baritore si dhe praktikën e peshkimit. Flet për doket dhe zakonet e shqiptarëve; për monogaminë; për rolin e kanunit në jetën e përditshme; për rolin e gruas brenda familjes si dhe jashtë saj (sepse përveç punëve të shtëpisë, gratë merreshin edhe me punët në arë, kur burrave u duhej të fshiheshin për shkak të gjakmarrjes); përshkruan martesën si një kontratë blerjeje midis babait të nuses dhe të fejuarit.

Me interes është edhe rrëfimi i fotografit Luciano Morpurgo (1886-1971) i cili përqendrohet në qytetin e Shkodrës, dhe e përshkruan atë si qytet dinamik dhe si qendër ekonomike dhe kulturore. Sipas tij, Shkodra është qyteti më i bukur dhe më i përparuar i Shqipërisë, me pazaret e tij të gjalla dhe të pasura, me urën veneciane, me kalanë që mbizotëron qytetin, me shpirt kozmopolit ku mund të dëgjohen gjuhë të ndryshme (1934).

Vizioni i Shqipërisë ndryshon sërish kur bëhet fjalë për dërgimin e ushtarëve italianë në Shqipëri gjatë luftës së dytë botërore.

¹⁰ Giuliani (1929).

¹¹ Tafani (1932).

Franco Benanti (1913-1987), mjek në ushtrinë fashiste të Musolini-t, përshkruan në formë narrative kujtimet dhe përvojat dramatike të jetuara në Shqipërinë e Jugut. Ai tregon, nga njëra anë, tmerret e luftës, fatin e ushtrisë fashiste deri në kapitullimin e saj, vuajtjet e ushtarëve si dhe të popullsisë, varfërinë e fshatrave malore të Jugut, vështirësitë shkaktuar nga lufta, dhe, nga ana tjetër, ndihmën e shqiptarëve, mikpritjen dhe besën e popullsisë. Kujtimet e autorit krijojnë një tablo si për gjendjen e ushtrisë italiane, ashtu edhe për situatën e Shqipërisë së Jugut në atë periudhë të veçantë të historisë (1981, 2003).

Edhe gazetari Gianni Granzotto (1914-1985) tregon realitetin shqiptar të kohës në ditarin e tij shkruar gjatë luftës italo-greke në malet e Shqipërisë së Jugut (1985). Edhe në kujtimet e tij dalin në dukje vuajtjet e ushtarëve, vdekjet, bombat, shtëpitë e braktisura, karakteri i njerëzve, gjeografia e vendit.

Është e qartë se ky shkrim përmbledh një pjesë shumë të vogël të studimeve albanistike në Itali. Paraqitja e një kronologjie shteruese është një nismë jo pak e vështirë, pasi kërkon një punë të thelluar dhe voluminoze, çka vështirësohet nga fakti që për shumë studiues, të dhënat janë ende në dorëshkrim, e për të tjerë materiali as nuk është më në qarkullim. Për këtë arsye, autorja është e vetëdijshme se ky punim nuk mëton të pasqyrojë tërësinë dhe madhësinë e veprave të shkruara mbi këtë temë.

Sidoqoftë është e kuptueshme se çështja e gjuhës, e letërsisë, e kulturës, e gjeografisë dhe e historisë së Shqipërisë ka zënë vend dhe është shfaqur në fusha të ndryshme studimi, duke qenë se ka tërhequr vëmendjen e shumë shkencëtarëve dhe është bërë objekt i kërkimeve të tyre shkencore. Autorja shpreson që dikush tjetër mund ta çojë përpara dhe ta thellojë më tej këtë çështje.

BIBLIOGRAFI

- Almagià, R., "Albania", në *Enciclopedia Italiana*. 1929.
- Altimari, F., "Kostandini ose enigma kadareane e të vdekurit që kthehet mes të gjallëve", në Ismail Kadare, *VEPRA*, vëll. X. Onufri, Tirana, 2008.
- Altimari, F., "Ndihmesa e disa drejtimeve të reja metodologjike për përtëritjen e albanologjisë bashkëkohore: Leksikografia Tekstuale e Kompjuterizuar", në *Le prospettive dell'albanologia: il contributo degli Albanesi di Sicilia e di Calabria*, Palermo, 1996.
- Altimari, F., "Osservazioni sul passato presuntivo dell'arbëresh d'Italia e sulla formazione dell'ammirativo in albanese", në *Atti del XV Congresso Internazionale di Studi albanesi*, Palermo, 1992.
- Altimari, F., "Selman Riza dhe çështja e paskajores", në *Studime*, Prishtinë. 2010, 16-17.
- Altimari, F., "Studi sulla letteratura albanese della "Rilindja", në *Quaderni di Zjarri*. 1984,11.

- Altimari, F., “Un progetto di concordanze elettroniche di testi letterari albanesi: Origine di una ricerca”, në *Lingua mito storia religione cultura tradizionale nella letteratura albanese della Rilindja*, 1991.
- Altimari, F., *Naim Frashëri, Bagëti’ e bujqësija* (I pascoli e i campi). Introduzione, edizione critica, traduzione italiana e concordanza, CELUC, Rende, 1994.
- Altimari, F., *Zanoret hundore të gegërishtes dhe e-ja e theksuar e toskërishtes*, Akademia e shkencave e RPSSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, 1981.
- Ambrosini, R., “Elementi conservativi e innovativi nella struttura dell’albanese”, në *Etnia albanese e minoranze linguistiche in Italia*, Palermo, 1982.
- Ambrosini, R., “Su alcune caratteristiche storiche e tipologiche dell’albanese”, në *Nuovi orientamenti della linguistica e della letteratura albanesi*, Palermo, 1996.
- Baldacci, A., “*Itinerari albanesi*. Reale Società Geografica Italiana, Roma, 1917.
- Baldacci, A., “Scutari d’Albania”, në *Italia*, 1913.
- Baldacci, A., *L’Albania*. Istituto per l’Europa Orientale, Roma, 1929.
- Banfi, E., “Aree latinizzate nei Balcani e una terza area latino-balcanica (area della Via Egnazia)”. *Rendiconti dell’Istituto Lombardo – Accademia delle Scienze e Lettere – Classe di Lettere*, 106, Milano, 1972.
- Banfi, E., *Linguistica balcanica*, Zanichelli, Bologna, 1985.
- Barbarich, E., *L’Albania*, Enrico Voghera Editore, Roma, 1905.
- Bartoli, M., “Accordi antichi tra l’albanese e le lingue sorelle”, *Studi Albanesi* II, 1932.
- Bartoli, M., “Una norma dell’albanese e del greco e la questione delle velari ario-europee”, në *Rivista d’Albania* I, 1940.
- Belluscio, G., “A bifocal pronunciation of standard Albanian: Prishtina vs Tirana”, në *The Potentiality of Pluricentrism. Albanian Case Studies and Beyond*, Wiesbaden, Harrassowitz Verlag, 2018.
- Belluscio, G., “Fonematica contrastiva albanese-italiano”, në *Lingue e Contesti. Studi in onore di Alberto Mioni*, Padova, CLEUP, 2015.
- Belluscio, G., “Le “ispirazioni giovanili” di Ismail Kadare nella sua prima raccolta poetica Frymëzimet djaloshare (1954)”, në *La scrittura obliqua di Ismail Kadare*, Venezia, Granviale Editore, 2012a.
- Belluscio, G., “Le vocali toniche dello shqip”, në *Quaderni del Dipartimento di Linguistica dell’Università della Calabria*, 7, Serie Albanistica 1, 1993b.
- Belluscio, G., “Leggere Kadare in italiano tra riscritture e ‘mistificazioni’”, në *Leggere Kadare. Critica - Ricezione – Bibliografia*, Milano, Biblion Edizioni, 2007.

- Belluscio, G., “Mbylltoret e shqipes. Cilësia e tyre fonetike, gjatësia dhe VOT-i”, në *Proceedings of the Conference “In Memoriam Waclaw Cimochoowski”*, (Toruń (Poland), Wydawnictwo Uniwersytetu Mikolaja Kopernika, Toruń, 2005.
- Belluscio, G., “NOBELESSE OBLIGE!”, në *Kadare europeo e la cultura albanese oggi*, Roma, Bulzoni, 2011.
- Belluscio, G., “Nuovi materiali per la fonetica della parlata di Vermosh (Albania settentrionale) confrontati con i dati dell’Atlante dialettologico della lingua albanese (ADGJSH)”, në *Nordalbanien - L’Albania del Nord*, Kovac, Hamburg, 2009b.
- Belluscio, G., “Premesse per una fonematica contrastiva albanese-italiano”, në *Quaderni del Dipartimento di linguistica dell’Università della Calabria*, 1993a.
- Belluscio, G., “Si shqiptohet shqipja në Ballkan?”), në *Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit*, Prishtina, ASHAK, 2012b.
- Belluscio, G., “Traduzioni della poesia albanese in italiano e il progetto di bi-traduzione dell’opera Ylli i zemrës (1937) di Lasgush Poradeci”, në *Traduzione tradizione*, Roma, Bulzoni, 2009a.
- Belluscio, G., “Varietete/variante fonetike “tendenciale” në përdorimin e kontrolluar të shqipes standarde në një emision televiziv të sotëm”, në *Proceedings of the XXXV International Seminar for Albanian Language, Literature and Culture*, Prishtina, ASHAK, 2016.
- Belluscio, G. e Antonio M., “Le vocali nasali e nasalizzate dell’albanese”, në *Lingue e linguaggi* 26, 2018.
- Belluscio, G. e Monica G., “Thethi e la sua parlata. Osservazioni di carattere linguistico e culturale dopo un’indagine sul campo”, në *Wir sind die Deinen. Studien zur albanischen Sprache, Literatur und Kulturgeschichte, dem Gedenken an Martin Camaj*, Otto Harrassowitz Verlag, Wiesbaden, 2010.
- Benanti, F., *La guerra più lunga, Albania 1943-1948*, Ugo Mursia Editore, Milano, 2003.
- Benanti, F., *Nidi d’aquile*, Edizioni Greco, Catania, 1981.
- Bonfante, G., “Albanese ed Illirico”, në *Iliria*, 1976, 5.
- Camarda, D., *Saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese*, E. Vignozzi e C., Livorno, 1864.
- Chetta, N., *Tesoro di Notizie su de’ Macedoni*. Helix Media Editore, Contessa Entellina., 2002 (a cura di Mandalà, Matteo).
- Chiara, P., *Albania, Tipografia del giornale di Sicilia*, Palermo, 1869.
- Cordignano, F., “L’Albania nella storia e nella vita ossia visione panoramica di un piccolo mondo primitivo”, në *Rivista d’Albania*, 1941.
- Cordignano, F., *Dizionario albanese-italiano e italiano-albanese*, Hoepli, Milano, 1934.

- Cordignano, F., *Epojeja kombtare e popullit shqiptar*, Shkodër, 1925.
- Cordignano, F., *In Albania*. Società Editrice Dante Alighieri, Roma, 1940.
- Cordignano, F., *La Poesia epica del confine nell'Albania del nord*, Tipografia del Seminario di Padova, 1930.
- Cordignano, F., *Lingua albanese*, Hoepli, Milano, 1931.
- Da Lecce, F. M., *Osservazioni grammaticali nella lingua albanese*, Roma, 1716.
- De Rada, G., *Antichità della nazione albanese e sua affinità con gli Elleni e i Latini*, Napoli, 1864.
- Di Giovine, P., "Tracio, dacio ed albanese nella prospettiva genealogica". *Rendiconti della Classe di scienze morali, storiche e filologiche dell'Accademia Nazionale dei Lincei*. Serie VIII, 1979, 34.
- Di Giovine, P., *Il gruppo ct latino in albanese*. Università di Roma, 1982.
- Fortino, I. C., "Dal realismo socialista a una nuova letteratura albanese, në *Hylli i Dritës*, 1994. 5-6.
- Fortino, I. C., "Un'incursione ottomana in Albania nella rivisitazione letteraria di Ismail Kadare", në *I Turchi, gli Asburgo e l'Adriatico*, Duino, 2007.
- Galanti, A., *L'Albania: notizie geografiche, etnografiche e storiche*, Società Editrice Dante Alighieri, Roma, 1901.
- Genesin, M., "Categorie grammaticali della frase nominale in ambito balcanico: definitezza, referenza ed il ruolo degli articoli in albanese, rumeno, neogreco", në *Zjarri*, 1998, 38.
- Genesin, M., "I plurali albanesi in (ë)na/ra: distribuzione e funzione tra valenza preferenziale e valenze alternative", në *La Sicilia, il Mediterraneo, i Balcani: storia, culture, lingue e popoli*, A. C. Mirror, Palermo, 2007.
- Genesin, M., "Il sistema di verbi apofonici", në *Lingua Mito Storia Religione Cultura tradizionale nella letteratura albanese della Rilindja. Il contributo degli Albanesi d'Italia*. Palermo, 1994.
- Genesin, M., "Morfologia storica del verbo albanese: alcune tendenze evolutive nello sviluppo dei temi del presente", në *Cinquant'anni di ricerche linguistiche: problemi, risultati e prospettive per il terzo millennio*, Edizioni dell'Orso, Alessandria, 2001.
- Genesin, M., "Per un'esplorazione del lessico albanese: alcune osservazioni in campo etimologico", në *Per Giovanni B. Pellegrin. Scritti degli allievi padovani*, Padova, 1991.
- Genesin, M., "Per una tipologia della ricerca etimologica albanese. Alcune brevi note", në *Atti del I Seminario internazionale di Studi Albanesi*, Cosenza, 1993.
- Genesin, M. e Giovanni B., "Thethi e la sua parlata. Osservazioni di carattere linguistico e culturale dopo un'indagine sul campo", në *Wir sind die Deinen. Studien zur albanischen Sprache, Literatur und*

- Kulturgeschichte, dem Gedenken an Martin Camaj*, Otto Harrassowitz Verlag, Wiesbaden, 2010.
- Genesis, M., *Studio sulle formazioni di presente e aoristo del verbo albanese*, CELUC, Rende, 2005.
- Giovanni, B., “Recenti sviluppi negli studi di fonetica sperimentale sull’albanese ed i suoi dialetti”, në *Quaderni del Dipartimento di linguistica dell’Università della Calabria*, 1995.
- Giuliani, S., *Assestamento e rinascita dell’Albania*, Tipografia del Popolo d’Italia, Milano, 1929.
- Giusti, G., “A Unified Structural Representation of Abstract and Morphological Case”, në *Studies in Comparative Germanic Syntax*, Kluwer, Dordrecht, 1995.
- Giusti, G., “Enclitic and proclitic articles in Albanian”, në *Theoretical and Empirical Studies in Albanian Syntax*, Lincom, Monaco, 2012.
- Giusti, G., “The categorial status of determiners”, në *The New comparative Syntax*, Longman, London, 1997.
- Gradilone, G., *Altri studi di letteratura albanese*, Roma, 1974.
- Gradilone, G., *La letteratura albanese e il mondo classico*, Roma, 1983.
- Gradilone, G., *Studi di letteratura albanese contemporanea*, Roma, 1997.
- Gradilone, G., *Studi di letteratura albanese*, Roma, 1960.
- Granzotto, Gianni, *Vojussa mia cara*, Mondadori, Milano, 1985.
- Gurga, G., “L’opera inedita di Marco La Piana “Grammatica storica della lingua albanese”, në *Aktuelle Fragestellungen und Zukunftsperspektiven der Albanologie*, Otto Harrassowitz Verlag, Wiesbaden, 2012.
- Gurga, G., *Francesco Maria da Lecce, Dittionario italiano-albanese (1702), botim kritik, me hyrje dhe fjalësin shqip*, Botime Françeskane, Shkodër, 2009.
- Guzzetta, A., *Ernest Koliqi, un poeta sociale*, Fascicolo primo. Tipografia Missioni Estere, Milano, 1968.
- Guzzetta, A., “I rapporti Arbëresho-Shqiptarë attraverso i secoli”, në *Il contributo degli albanesi d’Italia allo sviluppo della cultura e della civiltà albanese*, Palermo, 1987.
- Guzzetta, A., “Tradizioni storico-culturali e forma moderna nella prosa poetica di Ernest Koliqi”, në *8° Convegno di Studi internazionali albanesi*, Palermo, 1975.
- Guzzetta, A., *L’incanto del vero: i racconti di Ernest Koliqi fra tradizione e rinnovamento*, Scuola grafica salesiana, Palermo, 1974.
- Guzzetta, A., *Tracce della lingua albanese nel secolo XV nella documentazione veneta dell’epoca*, Scuola grafica salesiana, Palermo, 1968-1973.
- Kore, M., “Vepra e Francesco Maria da Lecce-s, burim i rëndësishëm për historinë e gjuhës shqipe”, në *Çështje të kontakteve gjuhësore e letrare italo-shqiptare*, ASA, Tiranë, 2020.

- La Piana, M., *Studi linguistici albanesi*. Palermo, 1939.
- Mandalà, M., “Alcune osservazioni sulle poesie di Martin Camaj”, në *Albanica*, 1991, 3.
- Mandalà, M., “Identiteti europian i shqiptarëve”, në *Ismail Kadareja dhe vepra e tij*, Argjiro, Gjirokastër, 2006.
- Mandalà, M., “Il Dizionario etimologico inedito di Marco La Piana”, në *Aktuelle Fragestellungen und Zukunftsperspektiven der Albanologie*, Otto Harrassoëitz Verlag, Wiesbaden, 2012.
- Mandalà, M., “Ismailand-i dhe urat kronotopike kadareiane”, në *Hylli i Dritës*, 2009, 26-1.
- Mandalà, M., “Kadare e gli altri: esempi di letture d’autore”, në *Shêjzat*, 2017, 3-4.
- Mandalà, M., “Kështjella e letërsisë dhe themelet e poetikës kadareiane”, *Parathënie*. Ismail Kadare, Vepra. Vëll. 3, *Rrethimi*, Onufri, Tiranë, 2008.
- Mandalà, M., “L’opera di Nicolò Chetta e la cultura albanologica italo-albanese nel XVIII secolo”, në *Dialetti italo-albanesi e letteratura*, Palermo, 1992.
- Mandalà, M., “L’opera inedita di Francesco M. Da Lecce: Il “Dittionario italiano-albanese” (1702)”, në *Atti del II Seminario Internazionale di Studi albanesi*, Cosenza, 1997.
- Mandalà, M., “Lineamenti di storia della lingua letteraria albanese: la questione della lingua nella Rilindja”, në *Sudost-Forschungen XXII*, 1990a, 5-11.
- Mandalà, M., “Palimpsest” di Martin Camaj”, në *Atti del I Seminario Internazionale di Studi albanesi*, Rende, 1993a.
- Mandalà, M., “Parathënie”, në *Mosmarrëveshja. Mbi raportet e Shqipërisë me vetveten*, Onufri, Tiranë, 2011.
- Mandalà, M., “Për botimin kritik të variantit në dorëshkrim të romanit “Dimri i vetmisë së madhe” të Ismail Kadaresë”, në *Shêjzat*, 2016b, 1.
- Mandalà, M., “Për një botim kritik të *Nëpunësit të pallatit të ëndrrave*. Shënime paraprake”, në *Kadare, leximi dhe interpretimi*, Onufri, Tiranë, 2016c.
- Mandalà, M., “Strukturat e rrëfimit në dramën *Besa* të Sami Frashërit. Biblos, 2005, 26.
- Mandalà, M., “Sul motivo della besa nella letteratura albanese”, në *Gli albanesi d’Italia e la Rilindja albanese*, Palermo, 1993b.
- Mandalà, M., “Urat kronotopike kadareane”, Biblos. 2009, 29.
- Mandalà, M., *Ismail kadare Mes së vërtetës së artit dhe mashtrimin të realitetit*, Onufri, Tiranë, 2018b.
- Mandalà, M., *Në studion Kadare. Botim kritik i dorëshkrimeve të romanit “Dimri i vetmisë së madhe”*, Onufri, Tiranë, 2016a.

- Mandalà, M., *Poesia popolare e poesia d'arte nella Rilindja. Gli studi e le ricerche degli italo-albanesi*, Palermo, 1990b.
- Mandalà, M., *Studi di storia della letteratura albanese*, A. C. Mirror, Palermo, 2004.
- Mandalà, M., *Studime albanologjike: filologjike-letrare dhe historiko-kulturore*, Naimi, Tiranë, 2018a.
- Mandalà, M., *Tesoro di notizie su de' Macedoni*, Helix Media Editore, Palermo, 2002.
- Mantegazza, V., *L'Albania*. Bontempelli & Invernizzi, Roma, 1912.
- Manzini, M. R. & Leonardo M. S., "Case' categories in the Geg Albanian variety of Shkodër", në *Res Albanicae*, 2012a, 1.
- Manzini, M. R. & Leonardo M. S., "Finite and non-finite complementation, particles and control in Aromanian, compared to other Romance varieties and Albanian", në *Linguistic Variation*, 2018, 18.
- Manzini, M. R. & Leonardo M. S., "Linkers in Aromanian in comparison to Albanian and Romanian", në *Rivista di Grammatica Generativa*, 2014, 36.
- Manzini, M. R. & Leonardo M. S., "Participio e infinito nella varietà di Scutari", në *Cinque secoli di cultura albanese in Sicilia*, Università di Palermo, 2003.
- Manzini, M. R. & Leonardo M. S., "Reducing 'case' to denotational primitives. Nominal inflection in Albanian", në *Linguistic Variation*, 2011, 11-1.
- Manzini, M. R. & Leonardo M. S., "Sintassi nominale e caso a Shkodër", në *Hylli i Dritës*, 2010, 3.
- Manzini, M. R. & Leonardo M. S., "The Interaction of DOM and Discourse-Linking in Arbëresh Pronouns: Case as Nominal Property", në *Theoretical and Empirical Studies in Albanian Syntax*. Lincom, Monaco, 2012b.
- Manzini, M. R. & Leonardo M. S., "The syntax of middle-reflexive and object clitics: a Case of parametrization in Arbëresh dialects", në *Studi in onore di Luigi Marlekaj*, Bari, 1999.
- Manzini, M. R. & Leonardo M. S., *A Unification of Morphology and Syntax. Investigations Into Romance and Albanian Dialects*. Routledge, London, 2007.
- Manzini, Maria Rita & Leonardo Maria Savoia, "Non-active voice in Albanian: Implications for the theory of movement", në *Studi sulle varietà arbëreshe*, CELUC, Cosenza, 2008.
- Martucci, D., "La "purezza della razza" e lo scandalo Cordignano", *Palaver*, 2016, 5-2.
- Meyer, G., *Etymologisches Wörterbuch der albanesischen Sprache*, Strassburg, 1891.
- Miracco, E., "Quale kadare leggere?", në *Kadare europeo e la cultura albanese oggi*, Bulzoni, Roma, 2011.

- Miracco, E., *Analisi di temi del romanzo "Kështjella" di Ismail Kadare*, Centro di studi albanesi, Università di Roma, 2007.
- Miracco, E., *Il romanzo "Sikur t'isha djalë" di Haki Stërmilli. Storia e critica del testo*, Roma, 2004.
- Miracco, E., *Storia del testo del romanzo "Piramida" di Ismail Kadare*, Edizioni Oxiana, Pomigliano d'Arco, 1999.
- Morpurgo, L., "In Albania. Note di viaggio" Nè *Corso di geografia a uso dei ginnasi e degli Istituti magistrali inferiori*, Sei, Milano, 1934.
- Ojetti, U., *L'Albania*. Torino, 1902.
- Paternò C. A., "Lettere sull'Albania del San Giuliano", në *Giornale d'Italia*, 1903.
- Pellegrini, G. B., *Avviamento alla linguistica albanese*, CELUC, Rende, 1998.
- Petrota, G., *L'Albania e gli albanesi*. Trimarchi Editore, Palermo, 1913.
- Petrota, G., *Popolo, Lingua e Letteratura albanese*, Tipografia Pontificia, Palermo, 1932.
- Petrota, G., *Svolgimento Storico della Letteratura albanese*, Scuola tipografica Boccone del Povero, Palermo, 1950.
- Pisani, V., "Les origins de la langue albanaise", *Studia Albanica*, 1964, 1.
- Pisani, V., *Saggi di linguistica strica*, Rosenberg & Sellier, Torino, 1959.
- Ratti, F., *L'Adriatico degli altri: (l'Albania nell'ora presente)*, Libreria internazionale, Firenze, 1914.
- Restelli, G., "Ricerche d'etimologia albanese", *Rendiconti*. Istituto Lombardo di Scienze e Lettere – Milano, 1956, vèll. 89-90.
- Restelli, G., "Ricerche di fonetica e morfologia albanese". *Rendiconti*, Istituto Lombardo di Scienze e Lettere – Milano. 1957, vèll. 89-90.
- Restelli, G., "Studi di fonetica albanese", *Rendiconti*. Istituto Lombardo di Scienze e Lettere – Milano, 1960, vèll. 94.
- Ribezzo, Francesco, "Premesse storico-linguistiche sull'autoctonia illirica degli albanesi", *Rivista d'Albania*, 1940, 2.
- Santucci, S., *Un viaggio nell'Albania settentrionale*, Edizioni digitali del CISVA, 2007.
- Schirò, G., *Storia della letteratura albanese*, Nuova Accademia Editrice, Milano, 1959.
- Solano, F., *Manuale di lingua albanese*, Corigliano Calabro, 1972.
- Tafari, F., *L'avvenire dell'Albania*, Hoepli, Milano, 1932.
- Tagliavini, C., *La stratificazione del lessico albanese: elementi indoeuropei*, Patròn, Bologna, 1965.
- Vaina, E., *La nazione albanese*, Catania, 1917.
- Valentini, G., *Acta Albaniae Veneta saec XIV-XV*, 1967.
- Valentini, G., *La legge delle montagne albanesi*, Olschki, Firenze, 1969.

